



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2018:044940

Datë: 15.07.2019

Numri i dokumentit: 00409138

P.nr.1865/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRIZREN DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI PENAL Sipas gjyqtarit Refki Piraj, me pjesëmarrjen e procesmbajtësit Halime Nixha në lëndën penale kundër të pandehurit Xh.B nga Prizren, me numër personal ..., për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga Neni 320 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr.04/L-082 (KPRK), duke vendosur sipas aktakuzës së Prokuroria Themelore Prizren - Departamenti i përgjithshëm nr. PP/II nr. 2318-6/17 , të datës 27.09.2017 ,në seancën publike të shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë15.07.2019, në praninë e Prokurorit të Shtetit Atnor Skoro të pandehurit Xh.B, të dëmtuarit K... , më datë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 15.07.2019 përpiloi, këtë:

A K T G J Y K I M

Xh.B i lindur me ... me nr. personal ... ne Prizren, e banim ne rr. ... nr..... nga i ati M. e ka te kryer shkollën e fillore, i martuar babe i ... fëmijve, punëtor, i gjendjes se dobët ekonomike, shqiptar – shtetas i R. te Kosoves.

Ë S H T Ë F A J T O R

Se prej datës se pa vërtetuar e deri me dt. 08.02.2017 ne Prizren ne shtëpinë e tij, përfiton nga shërbimi komunal përmes rrjetit përçues te rrymës apo rrjetit te shpërndarjes pa autorizim te shfrytëzuesit te autorizuar ne ate mënyrë qe ka shfrytëzuar energjinë elektrike, ka manipuluar me njehsorin me qëllim qe te shpenzojë me pak, ashtu qe energjia elektrike e shpenzuar nuk regjistrohet me qrast te dëmtuarës K... i shkakton dem material.

-këso dore ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KP-së.

Andaj gjykata ne kuptim te nenit 40, 43, 69, të KP-se, , te pandehurit i shqipton :

D E N I M M E G J O B Ë

Ne shume prej 120 (njëqindnjëzet) euro, të cilin dënim do ta paguaj ne xhirollogarinë e kësaj gjykate, nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi , e po qese

dënimi me te holla nuk mund te paguhet nga ana e te akuzuarit ne afatin e sipërpërmendur, i njëjti do te zëvendësohet me dënim burgu duke llogarite 20 euro , nje dite burg (6 dite burg) .

Obligohet I pandehuri qe ti paguajnë te gjitha shpenzimet e procedurës penale sa ato bëhen ne baze te llogarisë se gjykatës, kurse ne emër te paushallit gjyqësor te paguaj shumen prej 20 euro, e te gjitha këto ne afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi nen kërcenim te ekzekutimit te dhunshëm.

Ne zbatim te ligjit mbi mbrojtjen e viktimave te krimit te akuzuarit i caktohet taksa ne lartësi prej 30 euro te cilën është i obliguar ta paguaj ne xhirollogarinë e kësaj gjykate ne afat prej 15 ditesh nga dita e plotfuqishmërisë.

A r s y e t i m

Prokuroria themelore ne Prizren ka paraqitur aktakuzën . PP/II.nr. 2318-6/17 , të datës 27.09.2017. ndaj te akuzuarit Xh.B nga Prizreni , për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 te KP.

Prokurori i shtetit ne fillim te shqyrtimit, ne zbatim te nenit 3 te KP-së përkitazi me zbatimin e ligjit me te favorshëm kërkon nga gjyqtari gjykues qe te zbatohet neni 314 i KP ne fuqi krahasuar me nenin 320 te KP i cili ka qene ne fuqi ne kohen e kryerjes se veprës penale.

I pandehuri Xh.B në shqyrtimin gjyqësor, në tërësi ka pranuar veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës , e po ashtu ka pranuar edhe fajësinë .

Ne fjalën përfundimtare prokurori i shteti deklaroi se qëndron ne tërësi si ne aktakuze. Nga se këtu i akuzuari ne seancën e sotme te shqyrtimit gjyqësor e ka pranuar fajesine, konsiderojmë se gjykata duhet te ket parasysh sjelljen korrekte ne shqyrtim si rrethane lehtësuese, e sidomos vet pranimin e fajit.

I akuzuari deklaroi se i vjen keq per ate qe ka ndodhe i premtion gjykatës se me nuk do te përsëris këso vepra.

Gjyqtari gjykues përcaktoi se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit te fajit, pranimi është bere vullnetarisht, dhe mbështetet ne faktet e çështjes qe përmban aktakuza, aktakuza nuk përmban asnjë shkelje te qarte ligjore ose gabime faktike dhe pas marrjes se mendimit nga ana e prokurorit te shtetit ka pranuar pranimin e fajësisë.

Kjo gjykatë gjeti se në veprimet e të akuzuarit , plotësohen të gjitha elementet qenësore te veprës penale vjedhja e shërbimeve nga Neni 314 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr.06/L-074 (KPRK), prandaj dhe ia shqiptoi dënimin me gjobe duke qenë i bindur se me këtë lloj dënimi do te arrihet qëllimi i të njëjtit.

Me rastin e shqiptimit të dënimin kjo gjykate pati parasysh si rrethana lehtësuese, pranimin e fajit, shprehjen e pendimit , premtimin se në të ardhmen nuk do te kryej me vepra penale, sjelljen korrekte para gjykatës, është familjar , i gjendjes se dobët ekonomike, dhe se për herë të parë ka ra ndesh me ligjin. Me rastin e shqiptimit te dënimin me gjobe gjykata pati per baze gjendjen e dobët ekonomike te te akuzuarit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është mare ne kuptim te nenit 450 dhe 452 te KPPK-se.

Vendimi mbi udhëzimin ne kontest civil u mur ne kuptim te nenit 463 par.2 te KPPK.

Më sa u tha më lartë u vendos si ne shqiptim të këtij aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

2018:044940, 15.07.2019

G j y q t a r i

Refki Piraj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.